



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW
BODY

PSH. nr. 503/15

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 si dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje prej **Tefik Sylejmani – Kryetar**, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 503/15, të parashtruar nga operatori ekonomik N.N.“**Blendi Color**” me seli në Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Renovimi i objekteve shëndetësore në Podujevë**”, me nr. të prokurimit 615/15/148/521, të shpallur nga autoriteti kontraktues Komunës e Podujevës, në seancën e dt. 23 dhjetor 2015, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik N.N.“**Blendi Color**” me seli në Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Renovimi i objekteve shëndetësore në Podujevë**”, me nr. të prokurimit 615/15/148/521, të shpallur nga autoriteti kontraktues Komuna e Podujevës.
- II. **Aprovohet**, vendimi i autoritetit kontraktues Komunës së Podujevës, për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: “**Renovimi i objekteve shëndetësore në Podujevë**”, me nr. të prokurimit 615/15/148/521, si bazuar.
- III. Autoriteti kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim panelin shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .

Mos respektimi i këtij vendimi, detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

IV. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues N.N.“Blendi Color” me seli në Podujevë janë të paqëndrueshme, i bëhet konfiskimi i sigurimit të ankesës në shumë prej 500.00€ (pesëqind euro).

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues– Komuna e Podujevës, më dt. 15 shtator 2015, ka publikuar *Njoftim për kontratë* lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Renovimi i objekteve shëndetësore në Podujevë**”, me nr. të prokurimit 615/15/148/521.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar tetë (8) operator ekonomik. Komisioni i vlerësimit të ofertave pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të pranuar, konstatoj se nga tetë (8) operator ekonomik të cilët kanë oferuara për aktivitetin e prokurimit “**Renovimi i objekteve shëndetësore në Podujevë**”, me nr. të prokurimit 615/15/148/521, shtatë (7) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, ndërsa OE “Blendi color&Loshi Company”- nuk është në përputhshmëri administrative çmimi në paramasë nuk është në rregull, ka një çrregullim të paramasës me çmime. Komisioni në përbërje të plotë pas ekzaminimit dhe vlerësimit të të gjitha dosjeve të tenderit, konstatoi se OE “TRIBUNA” i plotëson kushtet e tenderit dhe në bazë të kriterit për dhënien e kontratës që është çmimi më i lirë, komisioni rekomandon që ky OE të shpërblehet me kontratë.

Autoriteti kontraktues më dt. 10 nëntor 2015, ka publikuar njoftimi për dhënie të kontratës.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës operatori ekonomik N.N.“Blendi Color” nga Podujeva, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-së.

Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është e pabazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, Nr. 04/L-042, me datën 25 nëntor 2015, ka autorizuar ekspertin shqyrtues Basri Fazliu, për të shqyrtuar zbatimin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore

Eksperti shqyrtues me datën 02 dhjetor 2015 i dorëzon, panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raportin e ekspertizës ka vlerësuar se autoriteti kontraktues në harmoni me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së, ka bërë ekzaminimin, vlerësimin e ofertës të operatorit ekonomik ankues, për faktin se oferta e operatorit ekonomik ankues është i papërgjegjshëm duke u bazuar në atë se në paramasën e ofruar ka ndërhyrje në çmime dhe njësi, po ashtu paramasa është e ç'rregulluar në atë formë sa nuk mundë të kuptohet se cilat janë çmimet për njësi apo sasi të paraqitura në të, njëherit pretendimi ankimor i parashtruar nga OE ankues është i pabazuar.

Bazuar në atë që u tha më lartë përmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ankues të hudhet poshtë si e pa bazuar, në harmoni me pikën 4 të vendimit të OSHP-së nr. 712/15, për faktin se operatorit ekonomik ankues nuk mundë të dëshmoj interes material sipas neni 111, parag. 1, pika 1.5 dhe 1.8, lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së, pasi që operatorit ekonomik ankues është i papërgjegjshëm, dhe në asnjë rrethanë nuk mundë dëshmoj interes juridiko-material dhe i njëjti nuk mundë të jetë fitues i kontratës për këtë aktivitet të prokurimit. Njëherit rekomandon panelin shqyrtues që të APROVOJ vendimin e autoritetit kontraktues Komuna e Podujevës, njoftimi për dhënien e kontratës të datës: 10 nëntor 2015, si i bazuar.

Autoriteti kontraktues Komuna e Podujevës, përmes parashtresës me shkrim të dt. 03 dhjetor 2015, e njofton panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 02 dhjetor 2015.

Operatori ekonomik ankues edhe pse është njoftuar me raportin e ekspertit shqyrtues të dt. 02 dhjetor 2015, brenda afatit ligjor nuk është deklaruar se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues në dhënë në raportin e ekspertizës së dt. 02 dhjetor 2015.

Paneli shqyrtues në pajtim me nenin 28 të Rregullores së punës së OSHP shqyrtoi shkresat e lëndës dhe bëri kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues i dt. 02 dhjetor 2015.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues konstaton se nuk qëndron për arsye se autoriteti kontraktues në harmoni me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së, ka bërë ekzaminimin, vlerësimin e ofertës të operatorit ekonomik ankues, për faktin se oferta e operatorit ekonomik ankues është i papërgjegjshëm duke u bazuar në atë se në paramasën e ofruar ka ndërhyrje në çmime dhe njësi, po ashtu paramasa është e ç'rregulluar në atë formë sa nuk mundë të kuptohet se cilat janë çmimet për njësi apo sasi të paraqitura në të.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues, konstatimeve të cekura në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, si dhe duke pasur parasysh për faktin se operatorit ekonomik ankues nuk mundë të dëshmoj interes material sipas neni 111, paragrafi 1, pika 1.5 dhe 1.8, lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së, pasi që operatorit ekonomik ankues është i papërgjegjshëm, dhe në asnjë rrethanë nuk mundë dëshmoj interes juridiko-material dhe i njëjti nuk mundë të jetë fitues i kontratës për këtë aktivitet të prokurimit, konstatoj se autoriteti kontraktues gjatë procesit të vlerësimit të ofertave lidhur me tenderin: **“Renovimi i objekteve shëndetësore në Podujevë”**, e ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Tefik Sylejmani

